

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Durrës

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË

“ART-DEKOR”

Kodi: AD-20

Miratoi:

DREJTOR

.....

Durrës, 2020

PROGRAMI I KURSIT TE VECANTE

“Art-Dekor”

(AD-20)

I. Profili Profesional i Art-dekoruesit.

a) Karakteristikat e Art-dekoruesit.

Art-dekoruesi është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në biznese dhe studio Arti që ofrojnë shërbime në fushën e Art-Dekorit.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, Ai duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe me *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të Art-Dekorit.

Suksesi i Art-dekoruesit është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: përqëndrimi, vullneti, fantasia, refleksioni, dashuria për të bukuren, gjakftohtësia, shkathtësia, përkujdesja, komunikimi me etike profesionale me eproret, kolegët, klientët, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia në punë, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe të përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e Art-Dekoruesit.

Profesioni i Art-dekoruesit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për projekte, ide dhe për zbatimin e tyre, lidhur kjo edhe me kërkesat si dhe sugjerimet e klientëve. Ai mund të punësohet në fusha të ndryshme që ofrojnë shërbime të Art-Dekorit si: studio Arti, ndërmarrje Artistike, Agjensi reklamash, Agjensi modelimi, si dhe mund të vetpunësohet për të ofruar këto shërbime.

Një individ mund të ushtrojë profesionin e Art-dekoruesit fillimisht si ndihmës apo bashkëpunëtor në projekte të ndryshme. Me përvojë punë dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e Art-Dekoruesit. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një Art-Dekorues mund të ndërmarrë disa funksione mbikqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si në sektorin privat ashtu edhe në atë shtetëror. Në këtë fazë të kualifikimit të tij, ai është i aftë t'i japë prioritet iniciativave personale, sidomos në sektorin e zhvillimit turistik, për të evidentuar krijimet artistike të kulturës dhe artizanatit shqiptar, shumë të vlerësuar dhe të kërkuar për veçoritë dhe karakteristikat e tyre.

Për të zhvilluar aktivitet privat në sektorin e Art-dekorit, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Art-Dekor”.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: artizanë, art-dekorues, operatorë veprash murale, teknikë mozaikësh, rifinitorë veprash artistike, krijues / ideatore hapësirash etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Art-Dekor”.

Në përfundim të Kursit “Art-Dekor”, kursantët do të jenë të aftë të:

- organizojnë punën dhe vendin e punës në një studio Art-Dekor;
- përdorin katalogë të ndryshëm, në format fizik dhe elektronik;

- përzgjedhin materiale të larmishme natyrore dhe artificiale;
- realizojnë vizatime të thjeshta bardhë e zi dhe me ngjyra;
- realizojnë dekorime në qelq;
- realizojnë dekorime në porcelan;
- realizojnë punime dekorative me kombinime materialesh;
- realizojnë dekoracione në plastikë;
- realizojnë punime në mozaik;
- realizojnë punime dekorative në volum;
- realizojnë punime në pikturën murale;
- përdorin mjetet, materialet dhe instrumentet e punës;
- mirëmbajnë mjetet, materialet dhe instrumentet e punës;
- komunikojnë me etikë profesionale me kolegët, eprorët, klientët;
- zbatojnë kuadrin ligjor të veprimtarisë së asistent Art-Dekoruesit;
- kryejnë llogaritje ekonomike;
- zbatojnë rregullat e higjienës personale dhe të vendit të punës;
- zbatojnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Art-Dekor”.

Pjesëmarrësit në Kursin “Art-Dekor” duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Art-Dekor”.

300 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Art-Dekor”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mesimore
1	Hyrje ne profesionin e Art – Dekoruesit.	AD-01-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të Art-dekoruesit. 2. Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet, pajisjet dhe materialet e punës së Art-dekoruesit. 3. Kursanti përshkruan rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit. 4. Kursanti ideon ndërtimin e skicave të thjeshta për dekorimin e objekteve. 5. Kursanti përshkruan teknikat e punës në Art-Dekor.

2	Vizatime të thjeshta.	AD-02-20	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan konceptet bazë të vizatimit të thjeshtë. 2. Kursanti realizon vizatime të thjeshta bardhë e zi dhe me ngjyra.
3	Dekorime në Qelq dhe Porcelan.	AD-03-20	30 orë mesimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për fillimin e dekorimit të objektit prej qelqi/porcelani. 2. Kursanti realizon dekorimin e objektit prej qelqi/porcelani.
4	Dekorime në plastikë.	AD-04-20	30 orë mesimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për fillimin e dekorimit në objektin prej plastike. 2. Kursanti realizon dekorimin në objektin prej plastike.
5	Punime dekorative me kombinime materiale.	AD-05-20	30 orë mesimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për fillimin e punimit dekorativ me kombinime materiale. 2. Kursanti realizon punimin dekorativ me kombinime materiale.
6	Punime në Mozaik.	AD-06-20	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për realizimin e Mozaikut. 2. Kursanti realizon Mozaikun.
7	Punime dekorative në Volum.	AD-07-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për fillimin e punimit dekorativ në volum. 2. Kursanti realizon punimin dekorativ në volum.

8	Punime në Pikturën Murale.	AD-08-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për fillimin e Pikturës Murale. 2. Kursanti realizon Pikturën Murale.
----------	----------------------------	-----------------	--	---

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit ‘Art-Dekor’:

1. Moduli ‘Hyrje në profesionin e Art-dekoruesit’

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E ART-DEKORUESIT.	AD-01-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të Art-dekoruesit, me mjedisin, mjetet dhe materialet e punës, me rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, me krijimin e ideve për ndërtimin e skicave të thjeshta lidhur me dekorimin e objekteve, si dhe me përshkrimin e teknikave të punës në Art-Dekor.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM)	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të Asistent Art-dekoruesit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së Asistent Art-dekoruesit; - të argumentojë rëndësinë e Art-Dekorit në punën dhe jetën e përditshme; 	

dhe procedurat e vlerësimit

- të shpjegojë rëndësinë e perditësimit të risive në profilin e Asistent Art-dekoruesit;
- të shpjegojë rëndësinë e vëzhgimit të detajeve në procesin e dekorimit;
- të përshkruajë mënyrën e organizimit të punës, mjediset dhe kushtet e punës;
- të përshkruajë kërkesat profesionale të asistent Art-dekoruesit;
- të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të Asistent Art-dekoruesit;
- të përshkruajë kuadrin ligjor të veprimtarisë artistike të asistent Art-dekoruesit;
- të shpjegojë rëndësinë e komunikimit në mjedisin e punës;
- të zbatojë rregullat e komunikimit me etikë me klientët, eprorët, kolegët etj;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- të zbatojë rregullat e paraqitjes, qëndrimit dhe higjienës personale dhe mjedisore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet, pajisjet dhe materialet e punës së Art-dekoruesit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mjedisin e punës në një studio Art-dekori;
- të përshkruajë kushtet e punës në studio;
- të shpjegojë rëndësinë e ndriçimit të duhur në një studio Art-dekori;
- të shpjegojë rëndësinë e temperaturës së ambjentit në studio;
- të shpjegojë rëndësinë e pozicionimit të duhur karshi dritës;
- të shpjegojë rëndësinë e mirëmbajtjes së mjedisit të punës së asistent art-dekoruesit;
- të përshkruajë mjetet, pajisjet, materialet dhe instrumentet e punës së asistent art-dekoruesit;
- të tregojë rregullat e përdorimit dhe të ruajtjes së materialeve e të mjeteve të punës në Art-dekor;
- të përshkruajë procedurën e pastrimit dhe të mirëmbajtjes së peneleve pas çdo procesi punë;
- të përshkruajë mënyrën e ruajtjes, në kushte të pershtatshme, të të gjitha llojeve të bojrave pas procesit të punës;
- të përshkruajë rëndësinë e mirëmbajtjes së të gjithë aksesoreve të përdorur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të dallojë rreziqet në mjedisin e punës;
- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregulloreve të sigurisë dhe mbrojtjes në punë;
- të tregojë rëndësinë e përdorimit me kujdes të materialeve toksike si: bojra, diluente dhe ngjites të ndryshëm që përdoren në proceset e punës;
- të tregojë rëndësinë e përdorimit me kujdes të materialeve si: xham, plastike, gure (natyrore & artificiale);
- të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të mjeteve, materialeve dhe aksesoreve përpara fillimit të punës;
- të zbatojë rregullat e ruajtjes dhe përdorimit të materialeve dhe mjeteve të punës në Art-Dekor;
- të përdorë kutinë e ndihmës së shpejtë dhe të japë ndihmën e pare, në rast nevojë;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit në Art-dekor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4 Kursanti ideon ndërtimin e skicave të thjeshta për dekorimin e objekteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë rëndësinë e ndërtimit të skicave të thjeshta për dekorimin e objekteve;
- të shpjegojë rëndësinë e vendosjes së dimensioneve të duhura për ndërtimin e skicës së thjeshtë në funksion të objektit që do të dekorohet;
- të përqëndrohet në ambjentin që na rrethon për të tërhequr detaje dhe tematika lidhur me ndërtimin e skicës për procesin e dekorimit;
- të përshkruajë mënyrën e vendosjes së detajeve dhe komponenteve për ndërtimin e skicave të thjeshta;
- të përshkruajë mjetet bazë të punës për ndërtimin e skicave të thjeshta;
- të përshkruajë pajisjet dhe aksesoret që duhen për ndërtimin e skicave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 5 Kursanti përshkruan teknikat e punës në Art-Dekor.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknikave të ndryshme të punës në Art-Dekor;
- të përshkruajë teknikën e vizatimit të thjeshtë;
- të tregojë teknikën e prerjes me gërshtë dhe thikë;
- të tregojë teknikën e ngjites me materiale të ndryshme ngjites;
- të përshkruajë teknikën e përdorimit të bojrave në Art-Dekor;
- të përshkruajë teknikën e ndërthurjes së bojrave bazë;
- të shpjegojë teknikën e përdorimit të peneleve në bazë të teknologjisë së punës;
- të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të ngjyrave të shumëllojshme në Art-Dekor;
- të përshkruajë teknikën e dekorimit në qelq dhe porcelan;
- të përshkruajë teknikën e dekorimit në plastkë;
- të përshkruajë teknikën e punimit në letër dhe karton;
- të përshkruajë teknikën e dekorimit në kompensato dhe materiale druri;
- të shpjegojë rëndësinë dhe qëllimin e përdorimit të materialeve të riciklueshme në Art-Dekor;
- të tregojë teknikat e punimit me materiale të riciklueshem (natyrore dhe artificiale)
- të përshkruajë veçoritë e teknikave të dekoracionit në materiale të ndryshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore ose studio. Rekomandohen dhe vizita në galeri arti dhe në studio Art-dekori.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në studio Art-dekori. Atyre duhet t’iu jepen detyra të ndryshme që të vëzhgojnë dhe analizojnë mjedisin, mjetet, materialet, instrumentet e punës dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e art-dekoruesit. Ata duhet të nxiten që të

diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.

- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore, studio Art-dekori e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës në një studio Art-dekori dhe Galeri arti.
- Komplet i materialeve, mjeteve dhe instrumenteve të punës në Art - Dekor.
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Vizatime të thjeshta.”

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VIZATIME TË THJESHTA	AD-02-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me konceptet bazë të vizatimit dhe me realizimin e vizatimeve të thjeshta bardhë e zi dhe me ngjyra.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e Art-dekoruesit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	RM 1 Kursanti përshkruan konceptet bazë të vizatimit të thjeshtë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë konceptet baze të vizatimit të thjeshtë bardhë e zi dhe me ngjyra;- të përshkruajë veçantinë e formave të vizatimit;- të tregojë ngjyrat bazike dhe tonalitetet për të realizuar një vizatim;- të tregojë dimensionet dhe përmasat e objektit që do të vizatohet;	

- të shpjegojë kalimin e vizatimit nga formati 3D në 2D;
- të shpjegojë rëndësinë e vëzhgimit të objektit;
- të përshkruajë ndërtimin e figurave, linjave dhe kompozimin e formave të ndryshme;
- të shpjegojë rëndësinë e konceptimit të perspektives në vizatime të thjeshta;
- të përshkruajë objektin origjinal në formë, ngjyrë, raporte dhe përmasa.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti realizon vizatime të thjeshta bardhë e zi dhe me ngjyra.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë procedurat dhe hapat e punës për realizimin e vizatimit;
- të përzgjedhë objektin që do të vizatojë;
- të përshkruajë objektin origjinal në formë, ngjyrë, në raporte dhe përmasa;
- të përgatisë vendin e punës për fillimin e vizatimit;
- të përzgjedhë mjetet e punës dhe aksesoret për realizimin e vizatimit;
- të ndërtojë linjat e vizatimit të objektit;
- të përshtasë masat dhe distancat;
- të zhvillojë punimin e vizatimit të ndarë në pjesë;
- të punojë me linjat gjeometrike të skicës;
- të perfeksionojë punimin bardhë e zi;
- të përdorë lapsat me ngjyra të ndryshme për ngjyrosjen e vizatimit;
- të fillojë mbushjen e skicës me ngjyrat bazë;
- të vazhdojë mbushjen me përzierjen e ngjyrave;
- të kujdeset për realizimin e detajeve;
- të kontrollojë punën e kryer;
- të dallojë defektet e mundshme;
- të rifinojë punimin nëse është e nevojshme;
- të pastrojë mjetet, materialet dhe aksesoret e punës;
- të sistemojë mjetet, materialet dhe aksesoret e punës;
- të pastroje ambjentin e punës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë ose studio art dekori. Rekomandohen vizita dhe praktika në studio artistike dhe në galeri arti që kryejnë veprimtari artistike dekoracioni.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në klase-studio. Atyre duhet t’iu jepen detyra praktike për realizimin e vizatimeve të thjeshta bardhë e zi dhe me ngjyra.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore-studio e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës në një studio Art-dekori.
- Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për realizimin në praktike të çështjeve që trajtohen në këtë modul.
- Objekte të ndryshme që do të vizatohen në forma, permasa dhe ngjyra të larmishme.
- Aksesore të ndryshme si: lapsa, lapsa me ngjyra, vizore, gome, bojra akrilike, penele.
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Dekorime në Qelq dhe Porcelan”

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DEKORIME NË QELQ DHE PORCELAN.	AD-03-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurat e punës për dekorimin e objekteve prej qelqi dhe porcelani si dhe me realizimin e ketyre dekorimeve.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	

Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrije në profesionin e Art-dekoruesit” dhe “Vizatime të thjeshta”.
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	<p>RM 1 Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës per fillimin e dekorimit të objektit prej qelqi/porcelani. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e punës; - të përgatisë vendin e punës; - të përzgjedhë metodën e dekorimit (pikturë, aplikacione me materiale të ndryshme); - të përzgjedhë mjetet, materialet, instrumentet e nevojshëm për realizimin e dekoracionit si:(ngjites, ngjyrosës, prerës, bojra akrilike dhe penele); - të përgatitë vizatimin e thjeshtë (skicën) që do të përdoret për dekoracionin e objektit prej qelqi / porcelani. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Kursanti realizon dekorimin e objektit prej qelqi/ porcelani. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë hapat e punës per dekorimin e objektit prej qelqi/porcelani; - të vizatojë në objektin prej qelqi/porcelani skicën e dekoracionit të përgatitur paraprakisht; - të përshtasë skicimin në bazë të formës dhe përmasave të objektit prej qelqi/porcelani që do të dekorohet; - të fillojë dekorimin në objektin e zgjedhur; - të realizojë dekorimin sipas metodës së zgjedhur paraprakisht (pikturë, aplikacione me materiale të ndryshme); - të përqëndrohet në realizimin e detajeve; - të kontrollojë punën e kryer; - të dallojë defektet e mundshme; - të bëjë korrigjimin e defekteve nëse është e nevojshme; - të bëjë kujdes gjatë procesit të dekorimit të objektit prej qelqi/porcelani sepse janë materiale të thyeshëm; - të pastrojë pajisjet, materialet dhe instrumentët e përdorur për dekorim; - të pastrojë vendin e punës; - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike; - të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje - përgjigje me gojë.

- Vezhjim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në klasë-studio art dekori. Rekomandohen vizita dhe praktika në studio artistike dhe në galeri arti që kryejnë veprimtari artistike dekoracioni. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t’iu jepen detyra të ndryshme që të vëzhgojnë dhe analizojnë mjedisin, mjetet, materialet, instrumentet e punës dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e asistent art-dekoruesit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë në lidhje me dekorimin e objekteve prej qelqi dhe porcelani. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
--	---

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore, studio Art-dekori e pajisur me mjete dhe materiale pamore; - Mjedise reale të punës në një studio art-dekori. - Komplet i materialeve, mjeteve dhe instrumenteve të punës për dekorimin e objekteve prej qelqi/porcelani. - Objekte prej qelqi dhe porcelani të formave, madhesive dhe ngjyrave të ndryshme. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
---	--

4. Moduli “Dekorime në plastikë.”

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DEKORIME NË PLASTIKË.	AD-04-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurat e punës për dekorimet në objektet prej plastike si dhe për realizimin e këtyre dekorimeve.	

Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e Art-dekoruesit”, “Vizatime të thjeshta” dhe “Dekorime në qelq dhe porcelan”.
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	<p>RM 1 Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për fillimin e dekorimit në objektin prej plastike. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e punës; - të përgatisë vendin e punës; - të përzgjedhë metodën e dekorimit si: (pikturë, dekoracione me materiale të ndryshme); - të përzgjedhë mjetet, materialet, instrumentet e nevojshëm për realizimin e dekoracionit si: (ngjytës, ngjyroses, prerës, bojra akrilike dhe penele); - të përzgjedhë objektin prej plastike ku do të realizohet dekoracioni; - të përgatisë vizatimin e thjeshtë (skicën) që do të përdoret për dekoracionin e objektit prej plastike. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli.
	<p>RM 2 Kursanti realizon dekorimin në objektin prej plastike. Kriteret e vlerësimit Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë procesin e punës për dekorimet në objektet prej plastike; - të vizatojë në objektin prej plastike skicën e dekoracionit të përgatitur paraprakisht; - të përshtasë skicimin në bazë të formës dhe përmasave të objektit prej plastike të zgjedhur paraprakisht; - të fillojë dekorimin në objektin që do të dekorohet; - të realizojë dekorimin sipas metodës së zgjedhur paraprakisht (pikturë, aplikacione me materiale të ndryshme); - të përqëndrohet në realizimin e detajeve; - të kontrollojë punën e kryer; - të dallojë defektet e mundshme; - të bëjë korrigjimin e defekteve; - të bëjë kujdes gjatë përdorimit të materialeve që përdor për dekorim; - të pastrojë vendin e punës; - të pastrojë mjetet, materialet dhe instrumentet e përdorur;

- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- të zbatojë rregullat e higjienës, sigurise në punë dhe ruajtjes se mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vezhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë-studio. Rekomandohen dhe vizita në galeri arti dhe në studio Art-dekori.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në studio Art-dekori. Atyre duhet t’iu jepen detyra të ndryshme që të vëzhgojnë dhe analizojnë mjedisin, mjetet, materialet, instrumentet e punës dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e art-dekoruesit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë lidhur me dekorimet e objekteve prej plastike.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore, studio Art-dekori e pajisur me mjete dhe materiale pamore;
 - Mjedise reale të punës në nje studio art-dekori,
 - Komplet i materialeve, mjeteve dhe instrumenteve të punës per dekorimin e objekteve prej plastike;
 - Objekte plastike me madhesi,forma dhe ngjyra te ndryshme;
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. Moduli “Punime dekorative me kombinime materialesh.”

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME DEKORATIVE ME KOMBINIME MATERIALESH.	AD-05-20
-------------------------	--	-----------------

Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurat e punës për dekorime me kombinime materiale në objekte të ndryshme si dhe për realizimin e këtyre dekorimeve.
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e Art-dekoruesit”, “Vizatime të thjeshta”, “Dekorime në qelq dhe porcelan” dhe “Dekorime në plastike”.
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	<p>RM 1 Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për fillimin e punimit dekorativ me kombinime materiale. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e punës; - të përgatisë vendin e punës për fillimin e dekorimit me kombinime materiale; - të përzgjedhë mjetet, materialet, instrumentet e nevojshëm natyrore dhe artificiale si: (ngjitës, ngjyrosës, prerës, bojra akrilike, penele); - të përzgjedhë materiale të ndryshme si: copë, spango, litar, lëkurë, korniza etj.; - të përzgjedhë materiale natyrore si: rërë, guaska, guralecë etj. për realizimin e dekoracioneve; - të përzgjedhë metodën e dekorimit; - të përgatitë vizatimin e thjeshtë (skicën) që do të përdorë për dekoracion. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli.
	<p>RM 2 Kursanti realizon punimin dekorativ me kombinime materiale. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë procesin dhe hapat e punës për realizimin e dekoracionit me kombinime materiale; - të vizatojë skicën e përgatitur paraprakisht në objektin e zgjedhur për këtë lloj dekorimi; - të përshtasë skicën me madhësinë dhe formën e objektit; - të realizojë punime dekorative me ndërthurje të materialeve si: spango, litar, lëkurë, guaska, rërë, guralecë, duke i'u përshtatur objektit të zgjedhur dhe skicës së parapërgatitur; - të realizojë punime dekorative në korniza druri me ndërthurje të elementeve natyrore dhe ngjyrave akrilike;

- të përqëndrohet në realizimin e detajeve;
- të kontrollojë punën e kryer;
- të dallojë defektet e mundshme;
- të korrigjojë defektet;
- të tregojë kujdes për përdorimin e materialeve të ndryshme gjatë procesit të dekorimit;
- të pastrojë vendin dhe veglat e punës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vezhë me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë-studio. Rekomandohen dhe vizita në galeri arti dhe në studio Art-dekori.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në studio Art-dekori. Atyre duhet t'iu jepën detyra të ndryshme që të vëzhgojnë dhe analizojnë mjedisin, mjetet, materialet, instrumentet e punës dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e asistent art-dekoruesit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë lidhur me punimet dekorative me kombinime materiale.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore, studio Art-dekori e pajisur me mjete dhe materiale pamore;
 - Mjedise reale të punës në një studio art-dekori.
 - Komplet i materialeve, mjeteve dhe instrumenteve të punës për dekoracionet me kombinime materiale si: ngjithës, ngjyroses, prerës, bojra akrilike, penelë, spango, litare, lekure, guacka, rere, guralece, korniza druri etj.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesat, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

6. Moduli “Punime në mozaik.”

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NË MOZAIK	AD-06-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me përzgjedhjen e materialeve të ndryshme natyrore dhe artificiale, me organizimin e punës e të vendit të punës si dhe me realizimin e mozaikëve.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e Art-dekoruesit”, “Vizatime të thjeshta”, “Dekorime në qelq dhe porcelan”, “Dekorime në plastike” dhe “Punime dekorimi me kombiminime materialesh”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	RM 1 Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për realizimin e mozaikut. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të veshë uniformën e punës;- të përdorë elemente të larmishëm, të nevojshëm, në ndërtimin e nje skicë - ideje për realizimin e mozaikut;- të përgatisë skicën e detajuar të mozaikut që do të realizojë;- të përzgjedhë materiale të ndryshme natyrore apo artificiale të larmishme;- të mbledhe elemente prej guri, xhami, guaska etj. për realizimin e detajeve në mozaik;- të përzgjedhë mjetet, instrumentet e nevojshëm si: prerës, ngjitës, ngjyrosës, pastrues;- të klasifikojë materialet e mbledhura në bazë të formave, ngjyrave dhe dimensioneve;- të grupojë elemente të veçantë për të rritur dukshmërinë dhe stilin në mozaik;- të tregojë kujdes në përzgjedhjen e tyre;- të sistemojë në kuti të veçanta materialet e ndryshme si: prerës, ngjitës, ngjyrosës, pastrues;- të sistemojë aksesorët ndihmës;- të organizojë hapësirën e punës për fillimin e mozaikut. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	RM 2 Kursanti realizon Mozaikun. Kriteret e vlerësimit:	

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshtasë paraprakisht hapësirat në ambjentin e punës;
- të përshkruajë procesin dhe hapat e punës për ndërtimin e mozaikut;
- të parashtrijë variante, risi për realizimin e komponenteve të skices;
- të diskutojë mbi risitë për ndërtimin dhe realizimin e mozaikut;
- të veshë uniformën e punës;
- të përgatisë bazën e pozicionimit të mozaikut;
- të vizatojë skicën nga letra në bazën mbështetëse;
- të mbulojë hapësirat e projektit me materialet e përzgjedhura paraprakisht;
- të punojë me zona duke u kujdesur për detajet në fazën e ngjitjes;
- të kujdeset për pastrimin e zonës së punës ku është përqëndruar për të eliminuar mbetjet dhe skorriet;
- të ndjekë rradhën e punës sipas materialeve dhe ngjyrave;
- të rifinojë perfundimisht mozaikun duke u përqëndruar tek detajet;
- të kontrollojë punën e kryer;
- të dallojë defektet e mundshme;
- të korrigjojë defektet nëse është e nevojshme;
- të pastrojë mjetet, materialet dhe aksesorët e punës;
- të pastrojë ambjentin e punës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset reale të punës në një studio art-dekori. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të krijimtarive të ndryshme artistike, dekorative si dhe në galeri arti.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për përzgjedhjen dhe grumbullimin e materialeve të larmishme natyrore dhe artificiale. Atyre duhet t'u jepen detyra praktike lidhur me organizimin e punës e të vendit të punës për realizimin e mozaikeve. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me risitë në ideimin dhe ndërtimin e mozaikeve.

- Kursantet duhet të angazhohen në veprimtari praktike konkrete për realizimin e mozaikeve, fillimisht të mbikqyrur e me pas të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore, studio e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës.
- Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për realizimin e mozaikeve.
- Materiale të ndryshme natyrore dhe artificiale si: elemente prej guri, xhami, guaska etj. për realizimin e detajeve në mozaik.
- Mjete, instrumente të nevojshme si: prerës, ngjithës, ngjyroses, pastrues etj.
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

7. Moduli “Punime dekorative në volum”.

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME DEKORATIVE NË VOLUM.	AD-07-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me përzgjedhjen e materialeve, organizimin e punës, përgatitjen e vendit të punës si dhe me dekorimin e objekteve në volum.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore. Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrije në profesionin e Art-dekoruesit”, “Vizatime të thjeshta”, “Dekorime në qelq dhe porcelan”, “Dekorime në plastike”, “Punime dekorimi me kombinime materiale” dhe “Punime në mozaik.”.	

**Rezultatet e të
mësuarit (RM)
dhe procedurat e
vlerësimit**

RM 1

Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për fillimin e punimit dekorativ në volum.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të mbledhë informacione risi për dekorimin e objektit në volum;
- të përzgjedhë materiale të larmishme për realizimin e ideve me tematikë natyraliste, dekorative dhe festive (sipas llojit të dekorimit në volum që do të realizojë);
- të kerkojë ide për një stil të veçantë në funksion të Art-letër;
- të përzgjedhë materiale si: letër, karton, copë, lëkurë me trashësi, dimensione dhe ngjyra të ndryshme;
- të përzgjedhë gërshërë, spila, vizore për realizimin e objekteve minimale në volum;
- të përzgjedhë penele dhe bojra akrilike për dekorimin e ketyre objekteve;
- të përzgjedhë suporte, korniza etj;
- të sistemojë materialet e punës;
- të sistemojë instrumentet dhe aksesoret që do të përdorë në realizimin e objektit;
- të përgatisë vendin e punës për fillimin e punimit në volum;
- të përgatisë vizatimin e thjeshtë (skicën) që do të përdoret për dekorimin e objektit në volum.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-pergjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti realizon punimin dekorativ në volum.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë procesin e punimit dekorativ në volum dhe hapat e punës bazuar në 3 komponentë themelore: kreativiteti, manualiteti, qetësia;
- të veshë uniformën e punës;
- të përshtasë paraprakisht hapësirën në ambjentin e punës;
- të fillojë procesin e modulimit, të palosjes, të rrotullimit të materialeve si: letër, karton, copë, lëkurë etj;
- të ngjisë dekorimet e ndryshme dhe komponentët për realizimin e dekorimit sipas skicës së ndërtuar paraprakisht;
- të vazhdojë dekorimin me bojëra të ndryshme akrilike për një efekt më të bukur estetik;
- të ndërthurë materialet dhe dekoracionet e ndryshme për të krijuar një objekt në volum me stil të bukur;
- të kujdeset për realizimin e detajeve gjatë procesit të punës;
- të kontrollojë punën e kryer;
- të dallojë defektet e mundshme;

- të korrigojë defektet nëse është e nevojshme;
- të pastrojë mjetet, materialet dhe aksesorët e punës;
- të pastrojë ambjentin e punës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset reale të punës në nje studio art-dekori. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari dekorative si dhe në galeri arti.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli, lidhur me dekorimin e objekteve minimaliste në volum.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset reale të punës në nje studio art-dekori. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për perzgjedhjen e materialeve, organizimin e punës e të vendit të punës.
- Kursantët duhet të aktivizohen, në menyre të mbikqyrur e me pas të pavarur, për të realizuar objekte të ndryshme në volum me tematike natyraliste, dekorative dhe festive.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në nje studio art-dekori.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për dekorimin e objekteve në volum.
 - Suporte, korniza etj.
 - Materiale si: letër, karton, copa, lëkurë, me trashësi, dimensione dhe ngjyra të ndryshme.
 - Gërshërë, spila, vizore, bojra akrilike, penele.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

8. Moduli “Punime në Pikturën Murale”

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NË PIKTURËN MURALE	AD-08-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurat e punës për realizimin e pikturës murale, si dhe i aftëson ata për kryerjen e këtyre pikturave.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore. Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e Art-dekoruesit”, “Vizatime të thjeshta”, “Dekorime në qelq dhe porcelan”, “Dekorime në plastike”, modulin “Punime dekorimi me kombiminime materialesh”, modulin “Punime në mozaik.” dhe modulin “Punime dekorative në volum”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti parapërgatit vendin dhe mjetet e punës për fillimin e Pikturës Murale. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të kërkojë informacion, risi për ndërtimin e një pikturë murale si formë ekspresioni dhe komunikimi;- të zgjedhë vendin e duhur bazuar në dritën dhe hapësirën e nevojshme për realizimin e pikturës murale;- të përgatisë skicë-idenë paraprake për ndërtimin e pikturës murale;- të grupojë elemente të vecantë për të rritur dukshmërinë dhe stilin e veprës murale;- të përzgjedhë materialet e punës si: skelë, shkallë, mjete pastrimi, stukues, bojra akrilike, fiksues për bojra, rrulla dhe penele.- të kujdeset për manovrimin dhe përdorimin e mjeteve të përzgjedhura. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - pergjigje me goje.- Vëzhgim me listë kontrolli RM 2 Kursanti realizon Pikturën Murale. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të veshë uniformën e punës;- të përshtasë hapësirën dhe mjetet e punës në vendin e përzgjedhur për ndërtimin e pikturës murale;	

- të montojë skelën;
- të përgatisë faqen e murit ku do të punojë;
- të rregullojë, pastroje dhe të bëjë të njëtrajtshme faqen e murit duke përdorur furçë, mjete stukuese dhe pastruese;
- të përdorë vinovilin dhe solucionet fiksuese në faqen e parapërgatitur të murit;
- të vizatojë në mur pamjen e skicuar paraprakisht;
- të përgatisë bazën e bojrave akrilike;
- të përzgjedhë rrulat dhe penelet e nevojshëm për mbushjen e linjave kryesore të ide-projektit;
- të mbushë linjat kryesore të pikturës murale;
- të punojë në pjesë duke i dhënë rëndësi detajeve;
- të përpunojë detajet dhe të bëjë rifinituren përfundimtare të vepres murale;
- të kontrollojë punën e kryer;
- të dallojë defektet e mundshme;
- të korrigjojë defektet nëse është e nevojshme;
- të pastrojë mjetet, materialet dhe aksesoret e punës;
- të pastrojë ambientin e punës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vezhëm me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset reale të punës në një studio art-dekori. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari dekorative si dhe në galeri arti.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës, në hapësirat e zgjedhura paraprakisht ku do të realizohet piktura murale. Atyre duhet t’iu jepen detyra praktike për të zgjedhur vendin e duhur, bazuar në dritën dhe hapësirën e nevojshme; për grumbullimin e mjeteve dhe materialeve të punës si dhe për ndërtimin e pikturës murale.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me informacionet risi për ndërtimin e një pikturë murale si forme ekspresioni dhe komunikimi. Ata duhet të mbledhin informacione për dekorimin e këtyre punimeve artistike.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.

-
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës.
 - Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshem për realizimin e pikturave murale.
 - Skelë, furçë, rrula, penele, bojra akrilike.
 - Mjete stukuese dhe pastruese, vinovil dhe solucione fiksuese.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-